



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Vushtrri shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Arsimit
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i Lartë për Arsim
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	GJ28-5.64
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	22/12/2023
Afati për aplikim	23/12/2023 - 21/01/2024
Institucioni	Komuna Vushtrri
Departamenti	Drejtoria për Arsim
Divizioni	
Vendi i punës	Komuna e Vushtrrisë
Nr. i Referencës	RN00013032
Kodi	RPC0006571



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Analizon legjislacionin, politikat dhe procedurat lidhur me fushën e arsimit dhe rekomandon përmirësime me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore si dhe zhvillimin dhe realizimin e reformave arsimore;
3. Harton dhe zhvillon legjislacionin, politikat, strategjitë dhe procedurat standarde si dhe përcakton dokumentacionin shkollor për arsimin në nivel komunal;
4. Monitoron mbarëvajtjen dhe zhvillimin e edukimit dhe arsimit dhe rekomandon përmirësime me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit;
5. Mbështet dhe këshillon institucionet arsimore për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe gjithë përfshirjen e nxënësve në arsimim;
6. Identifikon dhe analizon nevojat për trajnime në arsimin e përgjithshëm dhe koordinon punën me zyrën e trajnimeve për organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit;
7. Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit dhe strategjive për arsimin dhe harton raporte periodike për procesin e zbatimit të legjislacionit dhe strategjive;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. - Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe eksperiencë në mësimdhënie.
- **Kualifikime të posaçme formale:** Nuk kërkohet
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën mësimdhënie.



4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit - **(të dokumentuara me pasqyrën e trustit pensional)**;
- Vërtetimin për zotësinë e plotë të veprimit **(pas pranimit në punë)**;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Certifikatën nga Gjykata (origjinali) - **(pas pranimit në punë)**;
- Certifikatën shëndetësore - **(pas pranimit në punë)**;
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende **(nëse aplikuesi ka punuar ose punon në institucione publike)**.

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 05/02/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

Nuk kërkohen.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë



9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Udhëzim për aplikim;

Bashkangjitur keni linkun në youtube për mënyrën e aplikimit përmes sistemit - platformës

<https://konkursi.rks-gov.net/>

<https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUeZI>

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

